

VENDIM
Nr. 509, datë 25.9.2025

**PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësive shtetërore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Ministria e Punëve të Brendshme është përgjegjëse për zbatimin e politikës së punëve të brendshme në Republikën e Shqipërisë, është aparati organizativ dhe profesional, që i shërben interesit publik me paanësi, duke zbatuar legjislacionin në fuqi, duke kryer shërbimet publike, duke hartuar e duke zbatuar politikat e përgjithshme shtetërore në çështjet e punëve të brendshme.

3. Ministria e Punëve të Brendshme ushtron veprimtarinë e saj, në përputhje me legjislacionin përkatës, kryesisht, por jo vetëm, në fushat e përgjegjësive shtetërore, të:

- a) rendit dhe sigurisë publike;
- b) luftës kundër krimit të organizuar dhe trafikut të qenieve njerëzore;
- c) menaxhimit të integruar të kufirit dhe migracionit;
- ç) azilit dhe shtetësisë;
- d) antiterrorit dhe ekstremizmit të dhunshëm;
- dh) administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nga krimi;
- e) veprimtarisë së prefektit të qarkut;
- ë) shërbimeve të gjendjes civile;
- f) hartimit të politikave, koordinimit dhe mbikëqyrjes së shërbimit të mbrojtjes nga zjarri;
- g) parandalimit, mbrojtjes, mbikëqyrjes dhe kontrollit/inspektimit të zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e tokës/territorit, ajrit, ujërave dhe pyjeve nga ndotja, dëmtimet apo ndërhyrje të kundërligjshme të çfarëdo lloji.

4. Vendimi nr. 604, datë 20.10.2021, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të Ministrisë së Brendshme”, i ndryshuar, shfuqizohet.

5. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama